

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 108 Regj.  
Nr. 917 Prot.

Tiranë më 23.09.2019

URDHËR

“Për vënien e sekuestros konservative”

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Unë, Natasha Laska, në cilësinë e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore “Tirana Bailiff s” sh.p.k., në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 1362 Akti datë 15.04.2014, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 108 datë 08.08.2019 kërkesën e kreditorit Raiffeisen Bank sh.a., ndaj debitorit Shoqëria “Ra Krom-Tirana” shpk në lidhje me titullin ekzekutiv “Kontratë Kredie Bankare nr. 5207 rep. nr. 2839 kol. datë 13.12.2011, ndyshuar me kontratë nr. 1511 rep. nr. 459 kol. datë 08.03.2013”.

Pas kalimit në ekzekutim të detyrueshëm si dhe Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit nr. 1278/1 prot, datë 23.04.2014, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 1362 Akti datë 15.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA SE:

Pala debitore ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në kushtet kur ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit nuk është kryer në mënyrë vullnetare dhe nga ana e përmbaruesit gjyqësor duhet të vendoset masa e sekuestros konservati në kuotat e titujt e pronësisë që debitori Shoqërisë “Ra Krom-Tirana” sh.p.k me NIPT K88016902A, disponon në Shoqërinë “SBM Energji” sh.p.k me NIPT L38319901M, me qëllim mostjetërsimin e tyre.

Në zbatim të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile, neneve 36, 37 pika (c) dhe nenit 53 të Ligjit nr. 26 datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat e titujt e pronësisë që debitori Shoqërisë “Ra Krom-Tirana” sh.p.k me NIPT K88016902A me administrator Gani Hoxha dhe Ahmet Ckurti, disponon në Shoqërinë “SBM Energji” sh.p.k me NIPT L38319901M, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre, deri në një urdhër të dytë të përmbaruesit gjyqësor.

2. Për veprimin apo mosveprimin na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Lidhur sa me sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

a) Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe cdo veprim apo mosveprim që do të kryhet në kundërshtim me këtë urdhër do të sjellë përgjegjësi penale për personat përgjegjës sipas nenit 320 të Kodit Penal.

b) Ky urdher mbahet dhe u njoftohet paleve te cilat kane te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 diteve.

Zyra Përmbarimore “TIRANA BAILIFF'S” sh.p.k.  
PËRMBARUES GJYQËSOR  
NATASHA LASKA

*Watosleo*  
